



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:194957
Datë: 30.08.2024
Numri i dokumentit: 06107436

C.nr.3354/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve D.B.K. me numër personal: F.K. me numër personal: F.Sh.G. me numër personal: të gjithë nga Prizreni, A.Sh. me numër personal: nga fshati Rogovë, komuna e Gjakovës dhe M.R. me numër personal: nga fshati Gjonaj, komuna e Prizrenit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson B.K. dhe F.G. të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 2,525.79 euro, jashtë seance, me datë 30.08.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve D.B.K., F.K., F.Sh.G. të gjithë nga Prizreni, A.Sh. nga fshati Rogovë, komuna e Gjakovës dhe M.R. nga fshati Gjonaj, komuna e Prizrenit, me të cilën kanë kërkuar që të: *“OBLIGOHET e paditura Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që ti kompensoi paditësit në këtë mënyrë: për mësimdhënësen D.B.K. kompensimin shtesë për shkak të inflacionit për vitin 2017 shumën prej 70.65€, për vitin 2018 shumën prej 69.12€, për vitin 2019 shumën prej 113.12 €, për mësimdhënësen F.K. kompensimin shtesë për shkak të inflacionit për vitin 2017 shumën prej 70.38€, për vitin 2018 shumën prej 68.76€, për vitin 2019 shumën prej 98.56 €, për mësimdhënësen F.Sh.G. kompensimin shtesë për shkak të inflacionit për vitin 2017 shumën prej 66.42€, për vitin 2018 shumën prej 64.92€, për vitin 2019 shumën prej 92.96 €, për mësimdhënësin A.Sh. kompensimin shtesë për shkak të inflacionit për vitin 2017 shumën prej 67.23€, për vitin 2018 shumën prej 65.76€, për vitin 2019 shumën prej 94.15 €, për mësimdhënësen M.R. kompensimin shtesë për shkak të inflacionit për vitin 2017 shumën prej 65.79€, për vitin 2018 shumën prej 64.32€, për vitin 2019 shumën prej 104.56€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Me kamat ligjore prej 8% në vit, e cila duhet të llogaritet nga data 17.04.2017.” e pabazuar.*

II. HEDHET poshtë padia e paditësve D.B.K., F.K., F.Sh.G. të gjithë nga Prizreni, dhe M.R. nga fshati Gjonaj, komuna e Prizrenit, në këtë çështje juridike kontestimore për kompensimin e inflacionit në pagë për periudhën kohore nga data 01.09.2019, deri me datë 31.12.2021 dhe e paditësit A.Sh. nga fshati Rogovë, komuna e Gjakovës, për kompensimin e inflacionit në pagë për periudhën kohore nga data 01.08.2019, deri me datë 31.12.2021, për shkak të ekzistimit të gjyqëvarësisë (litispedencës).

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit D.B.K., F.K., F.Sh.G. të gjithë nga Prizreni, A.Sh. nga fshati Rogovë, komuna e Gjakovës dhe M.R. nga fshati Gjonaj, komuna e Prizrenit, në këtë gjykatë me datë 22.09.2022, përmes të autorizuarve të tyre B.K. dhe F.G. të dy avokat nga Prizreni, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

Në padi kanë theksuar se në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, paditëseve ju takon shuma si në vijim: D.B.K. shumë prej 524.25 euro, F.K. shumë prej 522.06 euro; F.Sh.G. shumë prej 492.54 euro, A.Sh. shumë prej 498.75 euro dhe M.R. shumë prej 488.19 euro. Po ashtu kanë theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk kanë marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i kanë propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar, për përpilimin e padisë shumë prej 312.00 euro si dhe taksën gjyqësore.

E paditura Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 20.03.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se ju takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësit ushtrojnë padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se ju takojnë beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Tutje ka shtuar se e drejta për kompensim të inflacionit për vitin 2017 dhe deri datë 22.09.2022, është parashkruar, sipas nenit 353 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve kjo e drejtë është parashkruar. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 par.1 të Ligjit të procedurës Kontestimore (LPK), i cili ka përcaktuar se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadië, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadië”,* vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadië e paditësve D.B.K., F.K., F.Sh.G. të gjithë nga Prizreni, dhe M.R. nga fshati Gjonaj, komuna e Prizrenit, për periudhën kohore nga data 17.04.2017, deri me datë 31.08.2022 dhe për paditësin A.Sh. nga fshati Rogovë, komuna e Gjakovës, për periudhën kohore nga data 17.04.2017, deri me datë 31.07.2022. Ndërsa bazuar në nenin 262 paragraf 3 të LPK-së, ngase në mënyrë taksative është paraparë *“gjatë kohës së ekzistimit të gjyqëvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykimi i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë, të paraqitur më vonë”.* Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që vlerësoi kemi të bëjmë me të njëjtën çështje kontestimore ndërmjet palëve të njëjta.

Për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune pranë të paditurës, të caktuar në vendin e punës mësimdhënës, fakt ky i vërtetuar nga provat, përkatësisht listat e pagave, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e të dorëzuara nga pala paditëse.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë listën e pagave me numër EM00009946, për paditësen F.K. me numër EM00135353 për paditësen F.Sh.G. me numër EM00011534 për paditësen D.B.K. me numër EM00142903 për paditësen M.R. dhe me numër EM00096415 për paditësin A.Sh. të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpadië e paditësve është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet.

Gjykata, gjeti të bazuar prapësimin e të paditurës në parashkrim, pasi që sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.* Paditësit, D.B.K., F.K., F.Sh.G. të gjithë nga Prizreni, A.Sh. nga fshati Rogovë, komuna e Gjakovës dhe M.R. nga fshati Gjonaj, komuna e Prizrenit, kanë kërkuar kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, ashtu që paditëseve të iu kompensohen shumat si në vijim: D.B.K. shumën prej 524.25 euro, F.K. shumën prej 522.06 euro; F.Sh.G. shumën prej 492.54 euro, A.Sh. shumën prej 498.75 euro dhe M.R. shumën prej 48.19 euro, ndërsa bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”,* si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023, të datës 09.10.2023, ku në pikën II parashihet që: *“punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”.* Paditësit të drejtën për paraqitjen e kërkesës për kompensimin e inflacionit në pagë, e kanë fituar nga data 01.05.2017, e tutje për secilën pagë mujore të cilën nuk e kanë marrë me kompensimin e inflacionit, kurse kërkesëpadië e paditësve përmes shërbimit postar

në gjykatë është paraqitur me datë 22.09.2022. Nga kjo rezulton se paditësit padinë e kanë parashtruar pas kalimit të këtij afati prej 3 vitesh, ku si pasojë kanë humur të drejtën për të kërkuar nga gjykata që të detyrojë të paditurën që të bëj kompensimin e inflacionit në pagë, për paditësit D.B.K., F.K., F.Sh.G. të gjithë nga Prizreni, dhe M.R. dhe nga fshati Gjonaj, komuna e Prizrenit, për periudhën kohore nga data 17.04.2017, deri me datë 31.08.2022 dhe për paditësin A.Sh. nga fshati Rogovë, komuna e Gjakovës, për periudhën kohore nga data 17.04.2017, deri me datë 31.07.2022. Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij, aktgjykimi, duke e refuzuar si të pathemeltë kërkesëpadinë e paditësve, përkatësisht për paditësen D.B.K. kompensimin shtesë për shkak të inflacionit për vitin 2017 shumën prej 70.65€, për vitin 2018 shumën prej 69.12€, për vitin 2019 shumën prej 113.12 €, për paditësen F.K. kompensimin shtesë për shkak të inflacionit për vitin 2017 shumën prej 70.38€, për vitin 2018 shumën prej 68.76€, për vitin 2019 shumën prej 98.56 €, për paditësen F.Sh.G. kompensimin shtesë për shkak të inflacionit për vitin 2017 shumën prej 66.42€, për vitin 2018 shumën prej 64.92€, për vitin 2019 shumën prej 92.96 €, për paditësin A.Sh. kompensimin shtesë për shkak të inflacionit për vitin 2017 shumën prej 67.23€, për vitin 2018 shumën prej 65.76€, për vitin 2019 shumën prej 94.15 €, dhe për paditësen M.R. kompensimin shtesë për shkak të inflacionit për vitin 2017 shumën prej 65.79€, për vitin 2018 shumën prej 64.32€, për vitin 2019 shumën prej 104.56€.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që vlerësoi kemi të bëjmë me të njëjtën çështje kontestimore ndërmjet palëve të njëjta, andaj janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e këtij vendimi në kuptim të nenit 262 paragraf 3 të LPK-së, ngase në mënyrë taksative është paraparë *“gjatë kohës së ekzistimit të gjyqëvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykimi i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë, të paraqitur më vonë”*.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se në Gjykatën Themelore në Prizren, është në zhvillim procedura kontestimore me shenjën C.nr.2895/2022, C.nr.2915/2022, C.nnr.2922/2022, C.nr.2925/2022 dhe C.nr.2931/2022, mes palëve të njëjta dhe me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

Si rrjedhojë, gjykata vlerësoi se padia e D.B.K., F.K., F.Sh.G. të gjithë nga Prizreni, dhe M.R. dhe nga fshati Gjonaj, komuna e Prizrenit, në këtë çështje juridike kontestimore për kompensimin e inflacionit në pagë për periudhën kohore nga data 01.09.2019, deri me datë 31.12.2021, dhe e paditësit A.Sh. nga fshati Rogovë, komuna e Gjakovës, për kompensimin e inflacionit në pagë për periudhën kohore nga data 01.08.2019, deri me datë 31.12.2021, në këtë çështje kontestimore (C.nr.3354/2022), duhet të hedhet poshtë si e palejuar, për shkak të ekzistimit të gjyqëvarësisë (litispedencës) dhe atë me lëndët me shenjën C.nr.2895/2022, C.nr.2915/2022, C.nnr.2922/2022, c.nr.2925/2022 dhe C.nr.2931/2022.

Gjykata ka marrë në shikim lëndët në fjalë dhe ka konstatuar se me lëndën C.nr.2895/2022, është nxjerrë aktgjykimi i datës 30.08.2024, në të cilën është aprovuar kërkesëpadi e paditësit A.Sh. nga fshati Rogovë, komuna e Gjakovës, për kompensimin e inflacionit, për periudhën kohore nga data 01.08.2019, deri me datë 30.06.2022. Në lëndën me shenjën C.nr.2915/2022, me datën 15.05.2024, është nxjerrë aktgjykim me të cilën është aprovuar kërkesëpadi e paditëses M.R. për kompensimin e inflacionit për periudhën kohore nga data 01.09.2019, deri me datë 30.06.2022. Në lëndën C.nr.2922/2022, është nxjerrë aktgjykim me të cilën është aprovuar kërkesëpadi e paditëses F.K. për kompensimin e inflacionit për periudhën kohore nga data 01.09.2019, deri me datë 30.06.2022. Në lëndën me shenjën C.nr.2925/2022, është nxjerrë aktgjykim me të cilën është aprovuar kërkesëpadi e paditëses F.Sh.G. për

kompensimin e inflacionit për periudhën kohore nga data 01.09.2019, deri me datë 30.06.2022 dhe në lëndën me shenjën c.nr.2931/2022, është nxjerrë aktgjykim me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditëses D.B.K. për kompensimin e inflacionit për periudhën kohore nga data 01.09.2019, deri me datë 30.06.2022

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 262 paragraf3 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.3354/2022 datë 30.08.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.